




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI



100 Vjet Pavarësi

022
Nr. ... Prot.

Tiranë, më *12/11* 2012

KODI I ETIKËS SË MËSUESVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR
PUBLIK DHE PRIVAT

Miratohet

MYQEREM TAFAJ

MINISTËR



1. HYRJE

Mjedisi arsimor mund të jetë faktor mbështetës dhe motivues i të nxënit vetëm nëse ka në themel vlerat e parimet, të cilat ky mjedis synon dhe përpiqet t'i rrënjosë.

Këto vlera e parime gjenden të shprehura qartë në Kushtetutën e Shqipërisë, në legjislacionin për arsimin, në dokumentet bazë në të cilat është formuluar politika e arsimit, si: Ligji për arsimin parauniversitar, korniza kurrikulare, strategjia e arsimit parauniversitar e të gjitha dokumentet kurrikulare.

Këto vlera e parime duhet të qëndrojnë në themel të funksionimit të procesit arsimor dhe të gjithë mjedisit që e mundëson këtë proces.

Vlerat themelore mbi të cilat duhet të ngrihet shoqëria demokratike dhe që shkolla i ka në themel të misionit të saj janë: drejtësia, paanësia, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, dinjiteti etj. Parimet që drejtojnë procesin e arsimit bazohen në këto vlera universale dhe janë garanci për rrugën në të cilën duhet të zhvillohet ky arsimim.

Kodi i etikës është hartuar për të ndihmuar që mësuesi të marrë vendimet e duhura në rastet e dilemave etike me të cilat ai përballet gjatë ushtrimit të profesionit të tij.

Kodi i etikës së mësuesit ofron modelin e sjelljes që shoqëria vlerëson dhe kërkon si të nevojshëm në mënyrë që shkolla të mund të realizojë misionin e saj shoqëror, për një shoqëri demokratike.

2. PARIMET THEMELORE

Parimet bazë mbi të cilat hartohet kodi i etikës së mësuesit janë:

1. Parimi i **përkushtimit ndaj nxënësit**, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi në lidhje me procesin e të nxënit.
2. Parimi i **përkushtimit ndaj profesionit**, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi për përsosjen e cilësive të tij personale në funksion të të nxënit dhe të **mjedisit arsimor** që e mbështet atë në të gjitha drejtimet.

Mësuesi merr përgjegjësinë t'i përkushtohet nxënësit dhe profesionit, të jetë mishërim i standardeve më të larta etike dhe model i sjelljes, që buron prej tyre.

3. QËLLIMI

Qëllimi i kodit të etikës së mësuesit është:

- të ndihmojë mësuesin dhe punonjësit e tjerë të arsimit për të njohur, për të kuptuar dhe për të zbatuar standardet etike të nevojshme për realizimin e misionit të arsimit dhe për të marrë vendime në kuadrin e realizimit të këtij misioni;

